



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.334/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Ymer Hoxha anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, për shkak të Thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 22.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, e cila identifikohet me shenjën ZL.Anr.316/2017 e datës 21.10.2017, e parashtruar kundër subjektit politik AKR me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, me të cilën ka kërkuar që ti shqiptohet dënimi me gjobë, për shkak të Thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 22.10.2017 nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), me të cilën pretendon se kandidati për Kuvend Komunal të Ferizajt, nga subjekti politik AKR, Vesel Ramadani, në ditën e heshtjes zgjedhore me datën 21.10.2017 ka bërë fushatë duke shpërndarë foto në facebook-un e tij, ku bënë thirrje për ta votuar. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është shkelur neni 36 par.1 pika b) e LZP.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur një fotografi në lidhje me rastin në fjalë.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës BIRN dhe Internews Kosova, lidhur me shkeljen e pretenduar të Thyerjes së Heshtjes Zgjedhore nga ana e subjektit politik AKR,

Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga fotografia që gjendet në shkresat e lëndës nuk mund të identifikohet koha dhe data e shpërndarjes së fotografisë.

Nga arsyet e theksuar më lartë dhe duke u bazuar në nenin 117.2 dhe 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.334/2017 më datën 22.10.2017.



Kryesuesi i Panelit

Adnan Konushevci

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.